



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE  
MINISTRI

Nr. 1447 prot.

Tiranë, më 15/03/2020

URDHËR

Nr. 177, datë 15.03.2020

PËR

**MBYLLJEN APO KUFIZIMIN E LËVIZJEVE NË PARQE DHE ZONA TË  
GJELBËRTA**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 7 pika 4 dhe nenit 15 të Ligjit Nr.15/2016, "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive" i ndryshuar, si edhe në zbatim të udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19,

**U R D H Ë R O J:**

1. Mbylljen e parqeve publike si dhe të hapësirave të gjelbërta të rrethuara, në zona urbane, deri në një urdhër të dytë.
2. Kufizimin e lëvizjes në parqe dhe zona të gjelbërta të hapura, në zona urbane, duke respektuar detyrimin për të mos u grumbulluar në më shumë se 2 persona, të cilët detyrohen të respektojnë distancën prej jo më pak se dy metra midis tyre, deri në një urdhër të dytë.
3. Njësitë e qeverisjes vendore nxjerrin urdhëra specifik për zbatimin e pikas 1 të këtij urdhëri për parqet dhe hapsirat e rrethuara në territorin e tyre, si dhe ngarkohen strukturat e policisë vendore që të kontrollojnë respektimin e kushtëzimit të mësipërm duke patrulluar zonat e cituara.
4. Mosrespektimi i ndalimeve të kufizimeve mësipër dënohet sipas parashikimeve të nenit 35 gërma (c) të ligjit 15/2026 të ndryshuar me Akin Normativ nr. 2 datë 11.03.2020.
5. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri njësitë vendore, Inspektorati Shtetëror Shëndetësor dhe strukturat përgjegjëse të Policisë së Shetit dhe Policisë Bashkiake.
6. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.



MINISTRI

Ogerta Manastirliu